



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 3333 Prot.  
4

Pogradec, më 28.08 2023

VENDIM

Nr. 94, DATË 28.08.2023

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN E HEC-IT "SHPELLA POSHTË II", VEPËR MARRJE (DIGË DHEU) SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 0.994 HA NË EKONOMINË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE TALLË) NGA SHOQËRIA "LIRIA ENERGJI" SHPK.**

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore", të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikes 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gjurmës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, "Për Pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikes 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të Administrimit të pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", Këshilli Bashkiak:



## VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej **0.994 ha** pyll në ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Talle), për ndërtimin e veprës së marrjes (digë dheu), nga shoqëria "LIRIA ENERGJI" SHPK.
2. Shprehja e dakortësisë do ti dërgohet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, për vijimin e procedurave ligjore të heqjes nga fondi pyjor/kullosor.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
5. U shpall sot më datë 28 . 08 .2023.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

